



Në bazë të nenit 157 të Ligjit të Mbrojtjes Sociale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 104/19, 146/19, 275/19, 302/20, 311/20, 163/21, 294/21, 99/21, 236/22, 65/23 dhe 192/25), Komisioni për Sigurimin e Mjeteve të Shërbimeve Sociale nga Komunitet dhe Ofruesit e Tjerë, i formuar nga Ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve, shpall:

### KONKURS PUBLIK

Për ndarjen e mjeteve për shoqata dhe ofrues privatë të shërbimeve sociale, për ofrimin e shërbimeve sociale

#### 1. Lloji i shërbimeve:

Me këtë Konkurs Publik sigurohen mjete për shoqatat e qytetarëve dhe ofruesit privatë të shërbimeve sociale për ofrimin e shërbimeve të mëposhtme:

##### a) Shërbime në shtëpi:

-ndihmë dhe kujdes në shtëpi

##### b) Shërbime në komunitet:

shërbim i qëndrimit ditor

- Qendër për qëndrim ditor për persona me aftësi të kufizuara dhe me punë individuale. qëndrimi i përkohshëm

- Qendra për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.

#### 2. Shuma e mjeteve që ndahen dhe periudha kohore gjatë së cilës do të ofrohen shërbimet sociale

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve, do të sigurojë mbështetje financiare për zbatimin e shërbimeve sociale në përputhje me kapacitetin e përcaktuar të ofruesve të licencuar të shërbimeve në aktvendimin për dhënien e lejes së kryerjen së veprimtarisë në mbrojtjen sociale, si dhe në përputhje me çmimin e shërbimeve për përdorues të përcaktuar me Vendimin për përcaktimin e çmimeve të shërbimeve sociale në shtëpi, për mbrojtje jashtëfamiljare, për ndihmë dhe mbështetje profesionale, për qëndrim ditor, për qëndrim të përkohshëm, për këshillim dhe zëvendësim të kujdesit familjar për vitin 2026, të miratuar nga Ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve nr. 02-8269/1, dt. 22.12.2025, të përpiluar në përputhje me Metodologjinë për Formimin e Çmimeve të Shërbimeve në Varësi të Normativave dhe Standardeve për Ofrimin e Shërbimit Social ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 264/19). Për ofruesit e licencuar të shërbimeve sociale që kanë lidhur kontratë administrative për vitin 2025 për shërbimin social ndihmë dhe kujdes në shtëpi, në vitin 2026 do të sigurohen mjete numër të njëjtë të përkëdhelësve, për të cilët kanë qenë të financuar paraprakisht. Mjetet do të sigurohen për



çdo përfitues në baza mujore, për të cilin Qendra për Punë Sociale ka lëshuar aktvendim, nga dita e nënshkrimit të kontratës administrative deri më 31.12.2026.

a) Shërbime në shtëpi:

- Ndhimë dhe kujdes në shtëpi – 409 denarë në orë për përdorues

b) Shërbime në komunitet:

Qendër për Qëndrim Ditor

-33.489 denarë në muaj për përfitues të shërbimit në Qendrën për qëndrim ditor për personat me aftësi të kufizuara, për përfitues, respektivisht 1.522 denarë në ditë për përfitues

- 1.411 denarë për trajtim individual në qendër për qëndrim ditor për persona me aftësi të kufizuara;

qëndrimi i përkohshëm

- 45,413 denarë në muaj për përfitues shërbimi në qendër për qëndrim të përkohshëm për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore, përkatësisht 1,489 denarë në ditë për përfitues, pa shpenzimet e regjisë.

### 3. Dokumentet e nevojshme:

Parashtruesi dorëzon dokumentet në vijim:

1. Fletëparaqitjen për aplikim për sigurimin e shërbimeve (formati i rekomanduar është i publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk)),
2. Emrin e plotë dhe adresën e subjekteve me aktivitete të qarta të përcaktuara gjatë realizimit të programit për ofrimin e shërbimit social, për të cilin kërkohet ndarja e mjeteve,
3. Programin e punës me përshkrim të detajuar të aktiviteteve dhe plan konkret pune për zbatimin dhe periudhën e realizimit të programit për ofrimin e shërbimit social për vitin që do të financohet, me të cilat sigurohet realizimi i qëllimeve, aktiviteteve dhe shërbimeve të përcaktuara në konkursin publik, me mjetet e parashikuara,
4. Listën me të dhëna për stafin profesional dhe personat e angazhuar për ofrimin e shërbimit social,
5. Të dhënat kontaktuese për personin përgjegjës/koordinatorin për realizimin e programit të shërbimit social (emër, mbiemër, e-mail dhe numër telefoni),
6. Të dhënat për përvojën e punës në fushën e mbrojtjes sociale, në përputhje të kërkesave dhe të nevojave të konkursit publik, partneritete të realizuara, bashkëpunim ndërsektorial dhe bashkëfinancim të siguar (nëse ka),
7. Dëshminë për mekanizëm të vendosur të kontrollit të cilësisë së shërbimit dhe sistem ankese nga klientët (formularë),
8. Raportin vjetor të punës së shoqatës për vitin paraprak, përkatësisht për vitin 2025,
9. Certifikatë për tatime të paguara e lëshuar nga organet tatimore të ofruesit të licencuar të shërbimeve sociale, jo më e vjetër se gjashtë muaj (origjinal ose kopje e noterizuar),



10. Deklaratën e ofruesit të licencuar të shërbimeve sociale, të noterizuar se nuk ka marrë mjete nga ndonjë organ tjetër shtetëror ose njësi e vetëqeverisjes lokale për të njëjtat aktivitete të ofrimit të shërbimit,
11. Aktvendimin për dhënien e lejes së kryerjes së veprimtarisë në mbrojtjen sociale dhe të gjitha ndryshimet shtesë të tij (original ose kopje e noterizuar).

#### 4. Афатет për zbatimin e procedurës:

Konkursi Publik zgjat 7 ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore.

Shoqatat e interesuara të qytetarëve dhe ofruesit privatë të shërbimeve sociale mund t'i dorëzojnë fletëparaqitjet më së voni deri në orën 16:00 të ditës së fundit të афатит të Konkursit, përkatësisht më së voni deri në orën 09:00 të ditës pasuese nëse dita e fundit e konkursit bie në ditë jopune, përmes arkivit të Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve në adresën rr. "Dame Gruev" nr. 14, Shkup, në zarf të mbyllur, me shënimin: "Për Konkursin Publik për sigurimin e mjeteve për ofrimin e shërbimeve sociale".

Fletëparaqitjet, të cilat, dorëzohen pas këtij афати dhe me dokumentacion të paplotë, nuk do të shqyrtohen.

Komisioni për Sigurimin e Mjeteve, në афат prej 30 ditësh pas përfundimit të афатит për dorëzimin e fletëparaqitjeve, përpilon mendim drejtuar Ministrit të Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve.

Ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve, pas marrjes së mendimit nga ana e Komisionit për Sigurimin e Mjeteve për Shërbime Sociale nga Komunitat dhe Ofruesit e tjerë, miraton aktvendim për ndarjen e mjeteve.

Ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve, do të lidhë kontratë administrative, me të cilën rregullohen të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e ndërsjella në realizimin e mjeteve të dhëna, në афат prej 15 ditëve nga dita e përfundimit të aktvendimit për ndarjen e mjeteve.

Shoqatat ose ofruesit privatë të shërbimeve sociale, të cilët do të marrin mjete nga Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve, kanë дetyrim që të gjitha materialeve (të shtypura dhe elektronike), të cilat do të jenë të prodhuara në kuadër të ofrimit të shërbimit, në vend të dukshëm të vendoset:

Mbështetur nga:



Република Северна Македонија

### MINISTRIA E POLITIKËS SOCIALE, DEMOGRAFISË DHE TË RINJVE

Република Северна Македонија

**Министерство за социјална  
политика, демографија и млади**



Republika e Maqedonisë së Veriut

**Ministria e Politikës Sociale,  
e Demografisë dhe e të Rinjve**

